REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 913/19
Datë/Datum. 24.12.19
PRISHTINË - PR

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Visar BIBAJ – Exp. shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit 16.12.2019	Data e dorëzimit të raportit 24.12.2019	Nr. lëndës: **913/19**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.12.2019, OE "Profitech"shpk – Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 913/19, kundër propozimit për anulim te aktivitetit te prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me Automjet për transportin e veturave", me nr prok: 21500-19-7374-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Drejtësisë (MD).

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **170 000.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK ka shkelur nenin 59 i LPP-se (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP.

Pretendimi 1.
Ne si OE se bashku me oferte kemi dorëzuar autorizimin e prodhuesit EKIP.
AK, përkatësisht komisioni vlerësues i ofertave te AK – MD ka potencuar se mungon autorizimi i prodhuesit apo dilerit për shitjen . Ku pohim është i pa baze dhe si i tillë nuk qëndron.

Prodhuesi EKIP edhte prodhues i mbindërtimit ne baze te kërkesës se klientit , porositësit te mjetit i cili i përshtatet mbindërtimit siç mund te jete prodhues te ndryshëm te kamionëve.

Arsyeja tjetër se kemi çmim te larte po ashtu nuk qëndron pasi qe AK për ketë projekt ka parashikuar vlerën 170 000.00€.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesa mbi mundësit teknike dhe profesionale.

Kërkesa 3. OE ne rast se nuk është vet prodhues atëherë duhet te ofroj dëshmi autorizimin nga prodhuesi për shitjen te këtyre produkteve.

Dëshmia" Autorizimi duhet te jete me emër te projektit dhe numër te prokurimit për kete tender qe ofron. Autorizim për shitje i lëshuar nga prodhuesi ose dileri.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni vlerësues ka propozuar qe ky AP, te anulohet pasi qe ofertuesit kanë dhëne oferta me te larta se ato te tregut.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Profitech"shpk - Prishtinë

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues/ Ministria e Drejtesise, gjate këtij aktiviteti te prokurimin ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore, kanë të bëjnë kundër propozimit për anulim te aktivitetit te prokurimit, perkatesisht kunder arsyetimit te eliminimit ku AK/ MD, tekstualisht ka potencuar:

"Mungon autorizimi nga prodhuesi apo dileri i autorizuar nga prodhuesi per shitjen e ketyre produkteve.

Komisioni vlerësues ka analizuar çmimin e ofruar nga ana juaj dhe duke u bazuar ne LPP dhe RrUPP, neni 3 par 4.2 c) te sigurohet qe çmimi i kontraktuar nuk eshte me i lart se çmimi i tregut, konstaton qe oferta e dorëzuar nga ana juaj ka çmimin me te larte se çmimi i tregut. Andaj komisioni vlerësues rekomandon anulimin e kësaj procedure".

Përgjigje në pretendimet ankimore.

Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se parashtruesi i ankesës se bashku me oferte ka prezantuar letër autorizimin e datës 17/10/2019, te lëshuar nga prodhuesi turk "Ekip Aruç Ustu". Sipas përshkrimit autorizimi i është dhëne OE "Profitech", me qellim te aplikimit ne tenderin e AK- MD, te identifikuar me nr prokurimi dhe titull.

- AK, përgjatë fazës se vlerësimit te ofertave ka pasur dilema lidhur me ketë autorizim, rrjedhimisht ka kërkuar sqarim nga parashtruesi i ankesës dhe sqarimi i ofruar nuk e ka bindur AK-ne.
- Përmes sqarimit OE ankues përveç tjerash ka sqaruar AK-ne se Autorizimi është lëshuar nga prodhuesi "Ekip", e qe është prodhues i mbindërtimit ne baze te kërkesës se klientit porositësit.

Kërkesa e pikës 9.1&9.2, te FDT-se, ka qen e qarte për ofertuesit, është kërkuar: "*OE ne rast se nuk është vet prodhues atëherë duhet te ofroj dëshmi autorizimin nga prodhuesi për shitjen te këtyre produkteve*". Dëshmia" "*Autorizimi duhet te jete me emër te projektit dhe numër te prokurimit për ketë tender qe ofron. Autorizim për shitje i lëshuar nga prodhuesi ose dileri*".

Sipas katalogut te prezantuar nga OE ankues rezulton qe i njëjti ka ofertuar me Automjet te prodhuesit "Ford", ndërsa mekanizmin përcjellës për ngarkimin e veturës (krani) nga prodhuesit turk "Ekip Aruç Ustu", (ne ofertë nuk është prezantuar ndonjë autorizim i prodhuesit "Ford"), prandaj vlerësimi ynë për ketë pik ankimore është se AK, vlerësimin e ofertave e ka bere sipas kërkesës se DT dhe ne pajtim me nenin 59, te LPP-s.

Përgjigje 2. Arsyeja e dyte e eliminimit ku AK, ka potencuar se çmimi i ofertës është me i larte se çmimi i tregut, vlerësimi ynë është se AK para inicimit te aktivitetit te prokurimit ka qen dashur ta hulumtoi tregun dhe te parashikoi vlerën sipas tregut. OE ankues sipas procesverbalit te hapjes se ofertave ka ofruar çmimin brenda vlerës se parashikuar te projektit , prandaj ketë pike ankimore e kualifikojmë si te bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit te mbetet ne fuqi.

Raporti ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Profitech shpk - Prishtinë
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - Ministria e Drejtësisë.